



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD U PRIŠTINI – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN – OGRANAK U LIPLJANU

P.nr.139/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të akuzuarit P. K. nga fsh. B. K. Lipjan, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.4480/16, të dt. 01.02.2017, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me dt.27.03.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit Sh. B., dhe të pandehurit, në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

P. K., i biri i Shaip, i lindur më *data e lindjes...*, me vendbanim në fashatin B., K Lipjan, me nr. personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt.18.04.2016, në shtëpinë e tij në fashatin B., KK Lipjan, i pandehuri P. K. me qëllim që vetit t'i sjellë pasuri të kundërligjshme, ka keqpërdor energjinë elektrike pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar KEDS-it, ka bërë kyçjen nërrjetin elektrik pa njehsor elektrik, është furnizuar me energji elektrike në mënyrë ilegale, me ç'rast është pamundësuar regjistrimi i energjisë elektrike, me çka të dëmtuarës KIDS-it, i ka shkaktuar dëm në vlerën prej 263.79 euro,-

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-së,

Andaj gjykata, konform neneve 1, 2, 4, 6, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 320 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin e gjykon me,

DËNIM ME KUSHT DHE ME GJOBË

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 1(një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Me dënim me gjobë në shumë prej 150.-€ (njëqindpesëdhjetëeuro), të cilin dënim i akuzuari detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 46 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do të llogaritet shuma prej 20.-€.

DETYROHET i akuzuri, që të dëmtuarës KEDS-Departamentit Ligjor në Ferizaj t'ia kompensojë shumën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 263.79-€, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

DETYROHET i akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 20 euro si dhe shumën prej 30.-€ në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.4480/16 të dt.01.02.2017, e ka akuzuar të pandehurin P. K., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Prokuroria e shtetit në shqyrtimin fillestar, është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe se ky pranim bërë në pajtim me dispozitat e KPPK-së, dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri, dhe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit, ndërsa me rastin e përcaktimit të lartësisë së dënimit për të pandehurin, të merret si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë nga ana e të njëjtit.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, respektivisht për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe njëkohësisht nga gjykata ka kërkuar që me rastin e matjes së dënimit, të njëjtit ti shqiptohet një dënim sa më i butë, ndërsa i pandehuri deklaron se nuk ka pasur më shumë se 2 ditë që u pata vendosur në shtëpinë e re, dhe për ta siguruar energjinë jam detyruar ta lidhi direkt, dhe kësaj gjykate i ka premtuar se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të akuzuarit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen e mëparëshme të kryerësit, pra fakti se i njëjti për herë të parë bie ndesh me ligjin, rrethanat personale se i pandehuri nuk ka pasur më shumë se 2 ditë që është vendosur në shtëpinë e re, dhe për ta siguruar energjinë është detyruar ta lidhi direkt, dhe gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën penale të ngjashme e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 dhe 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.6 të KPPK-së, Vendimi mbi shpenzimet e Financimit të Kompensimit të Viktimave të Krimit bazohet në nenin 39 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore-juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN.

P.nr. 139/17 dt. 27.03.2018

Sekretarja juridike
Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.